

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Frosina Sylejmani - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve R.M. dhe P.M., të dy nga fshati ..., të cilët me autorizim i përfaqëson T.M. nga ..., Komuna e ..., kundër të paditurës Qeveria e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson N.A., me objekt të padisë kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 18.125 euro, duke vendosur sipas ankesës së paditësve, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.170/13, të datës 20.02.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.03.2018, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësve R.M. dhe P.M., të dy nga fshati ....., Komuna e Lipjanit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.170/13, i datës 20.02.2015, **VËRTETOHET**.

## **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.170/13, i datës 20.02.2015, e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve R.M. dhe P.M., të dy nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, e parashtruar kundër të paditurës Qeveria e Kosovës, me seli në Prishtinë, me të cilën kanë kërkuar që “të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit material të shkaktuar në shtëpinë e paditësve në kohën e përfundimit të luftës dhe atë për ½ e shtëpisë e cila gjendet në fshatin ..., secilit paditës t’i paguajë nga 6524.20 euro, si dhe të paditësit të dytë shumën prej 5,079.00 euro në emër të kompensimit të dëmit për objektet ndihmëse të tij, si dhe të detyrohet e paditura që paguajë shpenzimet e procedurës”.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor, kanë paraqitur ankesë paditësit përmes të autorizuarit të tyre, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe për shkak të vendimit për shpenzimet gjyqësore, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovojë si të bazuar ankesën dhe aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj ashtu që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësve.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

-Ankesa e paditësve është **e pa bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në gjykatën e shkallës së parë paditësit me datën 17.06.2004, kanë paraqitur padi për kompensimin e dëmit për pronën e tyre private, të precizuar në shqyrtimin kryesor, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që për

shkak të shkatërrimit të objekteve, si pasojë e ngjarjeve të vitit 1999, në mënyrë solidare t'ua kompensojnë dëmin e pretenduar në shumën prej 18.125 €, me kamatë ligjore për vonesë, e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatën e shkallës së parë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par.2, të LPK-së, dhe se drejtë është aplikuar edhe e drejta materiale e të cilat shkaqe ankimore i vështron gjykata e shkallës së dytë në bazë të detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Gjithashtu Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes rreth kërkesëpadisë së paditësve, e parashtruar kundër të paditurës Qeveria e Kosovës me seli në Prishtinë, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, e si rezultat i kësaj drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, për të cilat arsye aktgjykimi i atakuar është dashur të vërtetohet në tërësi.

Si rrjedhojë, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.1991/1, të datës 25.06.1999 (neni 1 i saj) parashihet se *“i gjithë pushteti legjistativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë, i vishet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm”*, ndërsa sipas para...fit 7 të rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nr.1244 e miratuar me 10.06.1999, janë autorizuar shtetet anëtare dhe organizatat relevante ndërkombëtare për të vendosur një prani ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë. Në para...fin 9 pika (d), të kësaj rezolute është vendosur që përgjegjësinë për çështjen e sigurisë publike në Kosovë, do ta ketë prania ndërkombëtare e sigurisë (KFOR-i). Ndërkaq në bazë të autorizimit të Sekretariatit të Përgjithshëm dhe me ndihmën e organeve tjera relevante ndërkombëtare është krijuar një prani civile ndërkombëtare në Kosovë (UNMIK), për administrimin civil në mënyrë që të vendoset një administrim i përkohshëm në Kosovë dhe një administrim kalimtar me zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse kalimtare për të siguruar kushte për një jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës.

Me dispozitën e nenit 8 para...fi 1, pika (a) të Kornizës Kushtetuese të Kosovës është paraparë se pushteti për të siguruar mbrojtjen e plotë të të drejtave dhe interesave të komuniteteve, është kompetencë e rezervuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Kombeve të Bashkuar, ndërsa me dispozitën e nenit 13 të Kornizës Kushtetuese të Kosovës është paraparë se *“asgjë në këtë Kornizë Kushtetuese nuk ndikon mbi kompetencat e Pranisë Ndërkombëtare të Sigurisë (PNS) në plotësimin e të gjitha aspekteve të mandatit të saj në Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Marrëveshjen Ushtarake Teknike (Marrëveshja e Kumanovës)”*. Për më tepër edhe me marrëveshjen teknike ushtarake të Kumanovës (që është pjesë përbërëse e rezolutës së OKB nr.1244) është përcaktuar neni 1 dhe 2 që përgjegjësinë për sigurinë dhe administrimin civil do ta marrin Kombet e Bashkuara dhe KFOR-i, si forcë sigurie në Kosovë.

Duke qenë se paditësit e bazojnë kërkesëpadinë e tyre në kohën e para themelimit IPVQ-ve, gjegjësisht periudhën në të cilën, siç edhe u cek më lartë, i gjithë pushteti legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor, si dhe ai i sigurisë në Kosovë ushtrohej nga UNMIK-u dhe KFOR-i (stafi i të cilave gëzojnë imunitet dhe privilegje si personel ndërkombëtar), rezulton se Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës, tani Qeveria e Republikës së Kosovës, nuk kanë legjitimacion real pasiv në këtë çështje juridike kontestimore, ngase siç edhe u cek më lartë, këto institucione janë formuar shumë më vonë nga koha kur paditësve i është shkaktuar dëmi i pretenduar. Nga kjo rezulton se me të drejtë gjykata e shkallës së parë kërkesëpadinë e paditësve të parashtruar ndaj të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar.

Nga të lartcekurat, Gjykata e Apelit në pajtim me dispozitat e nenit 195.1, pika d) dhe nenit 200, të LPK-së, vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.2112/15, datë 29.03.2018**

**Kryetari i Kolegjit,**  
**Lumni Sallauka**